



ASTRIT NURI

DRITARE TE HAPURA

VJERSHA

85H-1
N. 96

ASTRIT NURI

DRITARE TË HAPURA


Vjersha



54218

14067

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»



Tirazhi 1000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1970

KËNGË PËR KOMUNIZMIN

Ai tek ne do të vijë!
Kur nisëm marshimin e gjatë, nga 44-a,
Partia këtë na e tha:
— Ai s'do të vijë si nuse në taksi,
Por flakë i kuq nga flamuj e pankarta.



Prandaj më shumë
Këngë për Të,
Këngë për të madhen Parti,
Këngë per Njeriun e Ri.

Por mos harroni këngë për ata,
Që na u bënë fli,
Para se Komunizmi t'na vijë.

PARA EKSPOZITËS SË M.SHEHUT E M.KEPIT

Ku ju kam parë? Ku ju kam parë?
Ah, diçka dalluese ata s'kanë!
Le që kot mundohem:
Heronjtë e sotëm na kalojnë shumë pranë.

Ndoshta, ndoshta...
Me çakmakun tim keni ndezur cigare
Dhe kot më keni falënderuar ahore
Se e kishim ortakërisht:
Ju naftën kishit në çakmakun tim
Që ndoshta tua kam shkrepur diku miqësisht.

Ku ju kam parë? Ku ju kam parë?
Ah, diçka dalluese ata s'kanë!
Le që kot mundohem:
Heronjtë e sotëm na kalojnë shumë pranë.

POEZI MBI POEZI

Lavdia e popullit — një poezi;
Dy kokë nën ombrellën blu,
e hapur në shi
— më vete kjo
poezi;
PARTIA — poezi mbi poezi

URIM PËR VITIN E RI

Urimet zakonisht janë të shkurtëra,
Se fjalët dalin të filtruara,
Miqve
Në këtë natë u uroj horizonte të hapura,
Armiqve: —
 Shtigje të mbyllura,
Miqve —
 Këngë të pambaruara,
Armiqve —
 Buzë të mbyllura!

S H Q I P T A R È T

Po pe shkëndijë
Të shkëputur nga klithmë shkëmbi në mal,
Thuaj atje është rinia;
Po pe trase të ngritur në hekurudhë,
Thuaj atje është rinia;
Po pe njerëz, që kaldrëm shtrojnë,
Thuaj ata janë pionierë;
Po pe tytë pushke të zgjatur,
Thuaj atje janë kufitarët,
Shkurt...
Po pe njerëz me pushkë e kazmë,
Thuaj ata janë SHQIPTARËT.

NE VARRIN E NËNËS DËSHMORE

Kur vdiqe,
Gjoksin mbushur e kishe me trakte,
Sot unë dhe shokët
Ta kemi mbushur me lule shumëngjyrëshe.

Nënë, kam ardhur të uroj festën,
Moj nënë e merakosur.
Hesht ajo si mbishkrimi i shkurtër
Mbi varr i vendosur.

Nënë, merak për mua mos ki!
Kam Partinë, që zëvëndëson dhe ty,
Dhe 28 mijë!

H E R O I N A

(M. Tutulanit)

Margarita, Margarita!
Ne s'na njohu jeta,
Pér ty kemi dëgjuar
Nëpér këngët e ëmbëla,
Nëpér këngët e fortä.

Këngët thonë se me vdekjen
Këmbeu jetën Margarita,
Kaq thjesht, kaq shpejt,
Sikur këmbeu buqeta.

NJË DITË NË TRASE

Karrot e dorës venë e vijnë,
Karrot midis shinave lëvrijnë.
Një turist qëndron si piketë.
Heshtja e mbulon, ai s'flet.

Në blok diçka shënon
— Turist, hej turist,
Këtu s'ndërtohet pyramidë për Faraon,
Por lumturia e një populli 2 milion.
Këto zemra e këto karro
Këtë thonë.

DRITË DHE DASMË NË FSHAT

Gërnetë, mos ta harrofshim
Kurrë zërin tënd me oi, oi,
Ora dy pas mesnatës,
Dritat s'u shuan, dasma s'mbaroi,
Gërneta ndihej deri te kroi.

Daulle, kurrë mos të harrofshim,
Rropama jote na çau timpanin;
Krushqit uronin nusen e djalin,
Deri në mëngjez
Dritat ndezur donin t'i mbanin.

Gënetaxhi, sot të dua pranë,
Fshati dasmë përherë le të ketë,
Le të më mbushen sonte sytë me dritë,
Le të më gjëmojnë sonte veshët nga kjo
gërnetë.

T R A D H E T A R I T

Ti s'ke asgjë tē përbashkët me Atdhenë.
Kur Atdheu kërkonte nga çdonjëri dashuri,
Për tē ti zgjodhe rrugëdredhurën, tē poshtrën
tradhëti!

Kur Atdheu mërdhinte
E me zemrat tonë shpuzë duhej ngrohur,
Zëmra jote nxirrte tym e ftohtësi,
Ajo si një gërmadhë kish mbetur,
Ku s'kish asgjë, veç hi.

D E S H I R E

Rruga shtrin trupin drejt Vermoshit,
O ditët e mia të pare gjistruara aksioniste,
Kështu nga revolucioni në rrjesht u thirrshi,
Kështu me këngë e shqetësime ardhshi.

Cemi i lashtë në guriçka zhaurin,
Gurë të bardhë nxjerr ai në breg;
M'i nxirr ditët aksioniste dhe ti, o jeta ime,
Mënjanë që t'i shoh e t'i prek.

Kataraktet guximtare e shalëgjata
Hap duartë dhe i pres nga lart,
Për ditët aksioniste, o jeta ime,
Hapur i mbafsh dhe ti duart.

QYTETI NË ALARM

Errësira u përplas në rrugë, në dritare, si e dehur;
Asnjë rreze drite nga neonet tani mos kërko;
Qyteti kalon në alarm papandehur.

Natë më vigilente se kjo unë s'njoh.
Këngët grumbullohen në radio e s'dalin prej
radios,
Murmuritje kalimtarësh: — Mos e ndiz shkrepsen,
mos!

Drita motoçikletash të maskuara anembanë,
Lëvizje. Hapa të fuqishme. Sy që shkrepëtijnë.
Ecje. Rrugë dhe marshime.

Jashtë ka vetëm lëvizje, lëvizje.

Mangut në park e lashë dashurinë dhe unë
— Ej, Atdhe, ti qenke i qetë, ti qenke dhe furtunë!

ASAJ QE ERDHI

Babai tē ndaloi,
Eli?

I fejuari tē kērcēnoi pēr ndarje,
Eli?
Nëna derdhi lot qē tē tē mallēngjente,
Eli?

Ne po niseshim pēr nē Prenjas!
Ajo na pa shallet,
erdhī!
Ajo na dēgjoi kēngēn,
erdhī!
Ajo na pa duke duartrokitur,
erdhī!
— Tē lumtē, i thamē ne,
Eli!

AJSHTAINI NË STUDIM

Hëna lart po ndriste.
Bota, në qetësinë e natës,
Ëndrrat përkundte.
E ku ta dinte Hëna
Se, hap pas hapi,
E ndiqte me studime
Një farë Ajshtaini?!

Hëna hynte e dilte
nëpër konstelacione,
Që ëndrrat njerëzve
të mos u zgjonte.
Çapngadalë ecte,
Por Ajshtaini përsëri
me marifet e ndiqte!

Ajo me të shpejtë
trupin e lakuriqtë
Mes reve të zeza
e fshihte,
Sikur turp nga Ajshaini
t'i vinte,
Ndërsa ky shihte e diç shënonte,
I dukej sikur në hënë po jetonte.

~~54278~~

14067



TAKIM ME MËSUESEN E ABETARES

— Mësuese, mësuese — një ditë i thirra.
Siç më shtie një kovë me ujë në kokë mamaja,
Ashtu mbi ty vitet të kishin derdhur thinja.

— Mësuese, mësuese — prapë i thirra.
Ajo nga unë u drejtua.
(Dikur e njihja nga ecja dhe nga bluza)
Tashти si meteor në inkadeshencë
Po i shkëlqenin sytë nën syza.

Menjëherë më njohu; më puthi,
— Sa bukur, tha, na ra udha!
Unë ndjeva sikur fëminia
Më puthi dhe e putha.

Dje unë dhe ajo. .
Duke bashkuar në abetare gërmë. . .
— Ngreu, Titi, na thuaj, ç'do të bëhesh.
Unë s'përgjigjesha,
Në kokë kisha shumë ëndrra.

Sot ajo — pensioniste,
Ndërsa unë në jetë — zog,
Që kape në korie po deshe.

— Mësuese e dashur,
 mësuese e vjetër,
Sa qenke thinjur!
Le që dy-tre thinja më përkasin dhe mua,
Në mos më tepër.

R R U G È S

Autobusi mblidhte dhe derdhte njerëz nëpër
stacione,
Autobusi ecte drejt, merrte dhe kthesa,
Unë s'lodhesha së pyeturi fshatarin nga Vërzhezha,
— A, drita ilitrike, thosh, gjë e madhe besa!

Gjithë autobusi dëgjonte bisedën tonë për dritat,
Ndërsa fatorinua «harroi» t'na jepte biletat.

Fshatari çuditej me mua, të panjohurin,
— Ç'matuf! Si s'më pyeti një herë për Fuatin.
Kështu mund të mendonte fshatari nga Vërzhezha.
E ku ta dinte ai se unë që andej kthehesha.

— Me të mira! — tha, rregulloi kasketën,
Në zbritje fatorinos i kërkoi biletën.

SPORTISTJA E RE E LAGJES

Në mbrëmje në shtëpi vonë ktheheshe.
Nëna te praku të priste.

As çantën sportive prej shpine s'hiqje,
Kur ajo cirrej — Bijë na turpërove!

Por ti qeshje, nënën e puthje,
Nënën, që e vrinsin mendimet e kota.

— Nënë, shihe vajzën tënde sot në gazetë!
— Bijë, për ty ky është nder, edhe për mua!
Dhe për herë të parë ndodhte që bijën e vet
Nëna e puthte të veshur me tuta.

NJË NATË

Kur nata udhën u zinte,
Te porta e madhe me gur trokisnin miqtë e mirë.

— Urdhëroo, urdhëroo...

Pastaj babai u shtronte pak bukë, një kokërr
hudhër,

Pak shëllirë.

S'harronte babai të vinte mbi sofër
Dhe buzëqeshjen e dlierë.

Ndërsa atë natë ai e prishi traditën shtëpiake,
E futi në haur një mysafir mesnate.
Sa inat me babanë po më vinte,
Sa inat, nga ne pse ta ndante?

Po pse, po pse në haur?
Baba, më duket, s'e bëre si burrë!

Të nesërmen mora vesh në çesmën e thatë
Se natën gjermanët kërkuan një partizan në fshat.

«Po pse, po pse në haur?»
Qenkish pyetje e kotë se babai qenkish burrë!

NË MARSHIME

Në marshime
U lagëm, u nxehëm, teshtitëm;
Herë shoku më mbajti, herë e mbajta.
Por kuotën e arritëm.

Në marshime
Gjithkush ecte vetë,
Por kur rrëshqisnim
S'e linim shokun
T'na këpütej si komëtë.

Në marshime
Eja me ne, o mike,
Mos të të zëjë frika,
Kur xurxull na është bërë
Harmonika.

ASAJ QË S' ERDHI

Treni mbi hekura brinjët kërcet,
Ti vështrimin në pejsazhin e ftohtë hedh,
Në këtë trase sa u lodhën shokët e tu!
Por ti s'erdhe ahere me ta këtu.

Bileta të siguron. Ti mund të udhëtosh.
Pejsazhin e ftohtë sërish mund ta vështrosh;
Justifikime të kcta ti plot mund të gjesh;
Udhëto, udhëto! Por mbi shina mos buzëqesh!

K È N D O

— Këndo, këndo një herë...
Kur ishim të dy ajo më detyronte,
Por unë s'këndoja
Se frikë kisha
Mos zogjtë nga koria zboja.

— Këndo, këndo — ajo vazhdonte,
Pastaj zemërohej sa s'më shante,
Pastaj, e mërzitur, belbëzonte:
— Edhe thua që nënën e ke labe!

PËR ATA QË LUANIN DIKUR

Ne sot s'ju shohim ju,
Ju që u inkuadruat në 28 mijët,
Por dhe stadiumet ju s'na i latë bosh:
Fëmijët tuaj gjithkund mund t'i takosh.

Ne shohim këta
Sikur ju shohim ju,
Ne duartrokasim për këta
Sikur duartrokasim për ju,
Kur thurim ca vargje për këta,
Më parë i kemi thurur për ju.

Po, për ju!
Se ju e latë lojën përgjysmë!..
E si mund të luaje, kur në Shqipëri
Po frynin erëra të forta,
Kishte stuhi?

Ju ngjitët pushkën në mish,
Se Shqipëria, më parë se sportistë,
Luftëtarë ju kishte.

Por pati nga ju që s'luajtën më kurrë,
Që mbetën përherë në male,
Por prapë ratë të lumtur
E buzëqeshët,
Se korrët Fitoren e Madhe!

KUJDES, GJYSHE!

Ndonjëherë shkëputesh ti, e dashura gjyshe,
Nga Tirana
Për të na parë ne
E ne, ty thinjat e bardha.

Sa gëzohemi ne
Kur vjen gjyshja nga Tirana!

Shpesh, e dashur gjyshe, më thoshe:
— Gjurulldi e madhe, bir, ndër trena;
Të vij tek ju s'e kam të lehtë!
— Po tani, që u shtua hekurudha e re?
Kujdes, gjyshe,
Mos na shkosh ndonjëherë gjetkë!

DY GISHT LETËR ASAJ

Mundet të të thonë — Të la!,
Mundet të të thonë — S'të do!,
Për mua ti je gjithshka,
Atyre mos u beso!

Mundet të të thonë — E pashë me një tjetër;
Ishin dy!

Ti prapë mos u beso.
Siç duket, s'të njohën as ty,
Se ishe ti ajo.

IDIL AMERIKAN

Ka ditë që s'ka ngrënë Xhoi,
Si varkë lëkundet rrugës,
Përreth reklama, reklama, reklama;
Ai s'do t'i shohë, as edhe t'i cikë,
Sepse në cipë të stomakut
Atij mund t'i kenë mbirë dhe leshterikë.

Ka ditë që s'ka ngrënë Xhoi,
Ndaj dhe lëkundet trotuarëve të ndritshëm,
Të ndritshëm!
Qofshin dhe pasqyrë,
Ç'i do!
Llogari e ndyrë:
Dritë në rrugë,
Errësirë në fytyrë!

Ecën Xhoi.
E ndjek pas uria lakuriqe,
Në një reklamë zgërdhijet fytyra e presi-
dentit.

Qëndron Xhoi,
Qëndron përballë presidentit,
Mendon: — Çikago, s'do të jesh më siç je!
Ndërsa në trotuar u shpërndanë
Xham e qelqe.

NJË PLAKUT FANATIK

Në turn të tretë vajzën vetë e çoje,
Nga turni i dytë përsëri vetë e merrje,
— Të martoj unë kur të duash! — i thoshe,
S'ju ndave asaj, si hije kudo e ndoqe.

Autobusi erdhi përsëri më njëmbëdhjetë.
Shokun e jetës ajo e kish zgjedhur vetë,
Ty të mbuluan djersët në ballë
Dhe në kokë qeleshja — vërdallë.

KUR DHURUAM GJAK

1.

Me se ta krahasoj atë korridor të bardhë, të qetë,
pa nerva ambulance,

Ku ne dhuruam gjak?

Patjetër me një llogore, hapur në tokë gjer' e gjatë.

2.

E c'mund të mendosh para shiringës së shkallëzuar
poshtë e lart?

Patjetër një shok, që të kërkon dy gram gjak,
Se kërkon të hyjë në luftë prapë.

3.

Një korridor i bardhë, i qetë, pa nerva ambulance,
Si një llogore,

Ku ndahet kafshata e thatë e cigaret,

Ku dhurohet gjak e ideologji proletare.

NË FAMILJE

Sa mbërrita nga zbori, ma priti mamaja:
— U, bir me këto rroba s'qenke pér t'u sharë!
— Pa na thuaj, — u hodh babai —
Si vajte me zbor, o shoku ushtar?

U skuqa unë këmbë e kokë,
Se s'kisha dalë në qitje dhe shumë mirë.
E përkthyen ata përreth heshtjen,
Më thanë: — Po pse kështu, or bir?! —

— Po ja, fshjekëza me thuprën duhet të bjerë...
Filloi spjegimin gjyshi nga minderi përbri.
M'u kujtua në çast komandant Novruzi
E krismat në poligonin e qullur në shi.

— Pastaj... mos harro, o bir i dashur,
Kemi qenë derë pushke denbabaden,
Përballë syve të gjyshit u thyen sytë e mi.
Unë e ndjeva veten të atij rrethi borxhli.

B L O Q E T

Citate për dashurinë plot mblodhe,
Mes vajzave fjalë për dashurinë ti hodhe,
Sa herë bloqe për to te kinkaleria bleve,
Kishe filluar ta merrje me të mirë dashurinë,
Ta përkëdhelje.

Faqet e bloqeve i kishe bërë në cep me numra,
Me të kuqe — citatet më të bukura,
Por çuditërisht tek ti u ul këmbëkryq mblesëria.
— Grisi meskin ato bloqe! — bërtet nëpër dhomë
Dashuria.

REVOLTË KUNDËR ERËSIRËS DHE MENDIMIT TË ERRËT

— Kam filluar të mos e kem të qartë
Pse po vijmë në park përherë në errësirë! —
Ndërsa ai u mundua t'ja conte mendjen më larg,
— O Lindita, sa e bukur je, sa e mirë! —

Pak më tej kishte plot dashurira,
Pak më tej kishte plot neone,
Këto takime, takime të errëta,
Nga shpirti ajo duhej t'i dëbonte.

— Kam filluar të mos e kem të qartë... —
Iku ajo, la pas errësirën dhe atë në park,
— Sa e bukur je dhe sa e mirë!..
Donte ajo t'ja thoshnin, por jo në errësirë.

A N A L O G J I

Kur isha i vogël
Më pyeste ndonji i panjohur apo kushëri:
— Kë do më shumë
Mamin apo babin?

Ndërsa skuqesha, s'flisja,
Vrapoja se isha fëmijë

Edhe tani
Më pyet ndonjë i panjohur apo kushëri:
— Ç'do më shumë, matematikën?
Se merresh edhe me poezi.

Prapë unë skuqem, s'flas,
Po s'vrapoj se s'jam më fëmijë

LAMTUMIRA E FUNDIT

21 breshëri artilerie.

(Qielli vietnamez ndër vite me predha u thinj)
Pas kësaj, qetësi. Heshtje
Në sheshin e madh Badin.

I rëndë ky arkivol!

Rëndoijnë shumë luftërat, hallet e popullit,
Durimi, shpërthimi, sytë e përgjumurë
Nënët pa djal', rrudhat mbi ball',
Plagët nga bombat me napalm.

Duar kombesh vënë mbi arkivol.
Për të ardhur këto minuta tek ti
U bë rrugë çdo paralel e meridian,
Se nderin e ke fituar më luftë,
O i pamposhturi Vietnam!

21 breshëri artilerie.
Pas kësaj, qetësi. Heshtje
Në sheshin Badin.

Vetëm fitorja, ja po trumbeton;
Nga xhunglat, ja po mbërrin,
A po e dëgjon, o presidenti
Ho Shi Min?

NË START

Ato trupin kanë përkulur si harqe në start,
Ndërsa gryka e revolverit shikon lart.

Rekorde në këto minuta presim nga ju si më parë,
Si këngën nga ai, që në dorë ka kitarë.

Një... dyy... Gjuri paksa mbi dhe,
Endrrat në ankth... Revolveri së fundi... tre!

Dhe plumb përpara, përpara më shpejt...
Ato dhe më shpejt kanë ecur në jetë.

KËNGA E MËSUESIT TË ARDHSHËM

Le të më përcjellë axhensia
Me përqafime, puthje e doçka
Edhe ca vjet
Sa të jem student.
Pastaj, do të më përcjellin, e di,
Në një dhomë, brenda me ca fëmijë
Dhe do të më thonë:
— I shikoni? janë bisqë revolucioni!

Dhe atëhere çdo ditë, çdo orë,
përherë
Në faqen e murit përkarshi
Për inspektim do kem mësuesin e madh:

Enver.

E G N A T I A

Një rrugë e heshtur
Prej kohe e pashkelur...
Nga larg më mbërrijnë
Hingëllima kuajsh,
Ecje vetmitare,

të pafundme karvanesh,
Nën dritë dielli e hëne.

Kanë rrjedhur çurk shekujt,
E kemi rrjedhur denjesisht
Nga Iliria.
Të uriturit stërgjyshërit tanë
S'i mposhti vapa e lagështia,
I mundoi shumë kotherja;
Ju buhavitën gjunjët së ecuri
Nëpër Egnatia.

Kanë rrjedhur çurk shekujt...
S'vumë anës kësaj rrugë neone,
S'mbollëm as agrume,
E lamë të heshtur, vetmitare,
Buzë kohës, pensioniste,
Por edhe të pashkelur
Prej armiqve.

Dhe le të rrijë përherë kështu
Egnatia,
Amanet prej të parëve,
Djersë e gjak i ilirianëve.

NË XHUNGLA KA PLUMBA

Ditë e natë me receptorin e telefonit ngele;
Veshët t'u mbushën me lajme e shifra zhgënnyese;
Si një ujk mes pyllit e katastrofës,
Ti bërtet e shurdhon linjat telefonike.

Kockat lanë ushtarë e gjeneralë,
Ti, Mister, kërkon fitore...
Por më kot, më kot e ke!
Në Saigon, në Da Nang, në të lashtin Hue
Ushtarët që dërgove c'pandehje se do gjenin?
Vajza me minifunde?
Nën palma dashuri e scriptize?
Shëndetin e klimës tropikale?
Jo, në Vietnam ka vetëm xhungla,
Kudo xhungla,
Dhe në xhungla —
plumba.

DY RRUGË

Dy rrugë — para syve,
Të dyja — malore,
Njëra e botës së vjetër dëshmitare,
Tjetra mban vulën e aksioneve rinore.

Le të kujtojë kjo rrugë e vjetër, të vjetrat!
Pabesinë pas shkëmbit, në errësirë pritat,
Plumbin në pajë, nuset fytyrëmbuluara,
Të hipur në mushka me zilet e gajasura.

Para nesh — rruga e Malësisë së Madhe,
Te kjo për dyzetë ditë lulëzoijeta jonë aksioniste,
Që pas nesh të rendnin bjeshkëve
Boritë e valëzuara të automobilave.

Dy rrugë — para syve,
Të dyja — malore,
Si bija të dy botëve,
Nuk zihen kurrë për dore.

UDHA E MBARË

Një shkurt 1967. Dielli lindi.

Lindi dita.
Turma njerëzish, të hipur në makina,
Po të jetë se zë po na bën lufta,
Timonin rrotullojmë, makinat do t'i quajmë
Autoblinda.

Por sot na' pret hekurudha!

Shokë,
Asnjëherë s'duam që emrat tanë
T'i humbasim heshtaz në harrime,
Me emrin Adem Reka
Ato duhet të jenë sinonime.

Udhë e mbarë!
Punë e mbarë!
Atdheu njerëzit për punë e luftë
S'i ka kurrë të ndarë.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Këngë për komunizmin	3
Para ekspozitës së M. Shehut dhe M. Kepit	4
Poezi mbi poezi	5
Urim për vitin e ri	6
Shqiptarët	7
Në varrin e nënës dëshmore	8
Heroina	9
Një ditë në trase	10
Dritë dhe dasmë në fshat	11
Tradhëtarit	12
Dëshirë	13
Qyteti ynë në alarm	14
Asaj që erdhi	15
Ajshtaini në studim	16
Takim me mësuesen e abetares	18
Rrugës	20
Sportistja e re e lagjes	21
Një natë	22
Në marshime	24
Asaj që s'erdhi	25
Këndo	26
Për ata që luanin dikur	27
Kujdes, gjyshe!	29
Dy gisht letër asaj	30

	Faqe
Idil amerikan	31
Një plakut fanatik	33
Kur dhuruam gjak	34
Në familje	35
Bloqet	37
Revoltë kundër erësirës dhe mendimit të errët	38
Analogji	39
Lamtumira e fundit	40
Në start	42
Kënga e mësuesit të ardhshëm	43
Egnatia	44
Në xhungla ka plumba	46
Dy rrugë	47
Udha e mbarë	49

54218

